

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT TE NXENËSVE

Proçesi i Përzgjedhjes së Shkollës - 2014


Pyetjet më të Shpeshta nga Prindi i Shkollës së Mesme

Kush duhet të marrë pjesë në Proçesin e Përzgjedhjes së Shkollës?

Proçesi i Përzgjedhjes së Shkollës është për nxënësit dhe familjet e tyre, të cilët dëshirojnë të aplikojnë për një shkollë **jashtë** zonës së tyre të banimit.

Cilat janë mundësitë e fëmijës tim?

Drejtorja Arsimore e Filadelfias (DAF) ofron shumë për nxënësit. Në tërësinë e saj, Drejtorja ka tre lloje shkollash, siç shtjellohen më poshtë.



Fëmija im po aplikon për një shkollë të mesme me pranim special, ose nga i gjithë qyteti? Çfarë duhet të bëj Unë?

- PËR NXENËSIT AKTUALE TË DAF
 - Aplikoni në shkollat që jeni të interesuar nëpërmjet sistemit online të Përzgjedhjes së Shkollës.
 - Rekordet mësimore të fëmijës do të dërgohen automatikisht në shkollat e kërkuara, nëpërmjet sistemit të Përzgjedhjes së Shkollës, të Drejtorisë Arsimore.
 - Disa shkolla kërkojnë një ese, intervistë, ose auditim. Ju lutemi, bashkëpunoni me këshilltarin e shkollës dhe vizitoni uebsajtet e shkollave, për rishikimin e të gjitha kërkesave specifike të tyre për pranim.
 - Kontaktoni shkollat në raste kërkesash për intervista, ose auditimesh.
- PËR NXENËSIT QË NUK JANË AKTUALISHT NXENËS TË DAF
 - Aplikoni në shkollat që jeni të interesuar nëpërmjet sistemit online të Përzgjedhjes së Shkollës.
 - Shkollat me pranim special dhe ato me pranim nga i gjithë qyteti kanë kërkesa që lidhen me rezultatet, frekuentimin dhe sjelljen; kështu që ato kërkojnë kopje të të dhënave më të fundit të fëmijës tuaj, në këto aspekte.
 - Ju duhet të paraqitni informacionin në vazhdim, në secilën shkollë ku keni bërë aplikim
 - Transkriptet e të dhënave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias
 - Kopje të testit më të fundit të standardizuar.
 - Tabela e mëposhtme do t’ju ndihmojë çfarë të përgatitni për paraqitje.

Aplikim për klasën e 9 ^{të}	Rezultatet mësimore dhe të testeve të standardizuara të klasave të 7 ^{ta}
Aplikim për klasën e 10 ^{të}	Rezultatet mësimore dhe të testeve të standardizuara të klasave të 8 ^{ta}
Aplikim për klasën e 11 ^{të}	Rezultatet mësimore dhe të testeve të standardizuara të klasave të 9 ^{ta}
Aplikim për klasën e 12 ^{të}	Rezultatet mësimore dhe të testeve të standardizuara të klasave të 10 ^{ta}

Si mund t'i gjej kërkesat e pranimit të një shkolle?

Drejtoria Arsimore online në direktorinë e Shkollave të Mesme, paraqet kërkesat e pranimit për secilën shkollë të mesme. Ju mund të merrni ndihmë prej këshilltarëve dhe mësuesve të shkollës tuaj, për kërkesat e pranimit të secilës shkollë.

Fëmija im ka aplikuar për shkollën e mesme të zonës. Çfarë më duhet të bëj në këtë rast?

Rishiko të gjitha programet mësimore, speciale dhe profesionale që ofron Drejtoria Arsimore e Filadelfias në shkollat e mesme. Apliko në shkollat që jeni i interesuar duke përdorur sistemin online të Përzgjedhjes së Shkollës.

Cili është afati kohor për Proçesin e Përzgjedhjes së Shkollës?

(Datat janë Subjekt i Ndryshimit)

Muaji	Aktiviteti
Tetor	Plotësohen Aplikimet
Janar-Shkurt	Vlerësimi i aplikimeve nga shkollat (shkollat me kritere pranimi)
Në fund të muajit Shkurt	Hidhen llotaritë
Mars	Dërgohen njoftimet fillestare për Statusin
Në fund të muajit Mars	Merren nxënësit nga lista e pritjes
Prill	Dërgohen njoftimet përfundimtare për Statusin

Si do të komunikojë Drejtoria Arsimore me mua?

- PËR NXENËSIT AKTUALE TË DAF – Të gjitha njoftimet do të dërgohen në familjet e nxënësve, nëpërmjet Portalit të Nxënësit dhe Prindit (Student and Parent Portals). Kjo përfshin dhe vendimet e marra të përzgjedhjes së shkollës.
- PËR NXENËSIT QË NUK JANË AKTUALISHT NXENËS TË DAF - Të gjitha njoftimet do të dërgohen në adresën e email-it të dhënë në aplikim. Kjo përfshin edhe vendimet e marra të përzgjedhjes së shkollës.

A duhet që të vizitoj shkollën?

Po. Drejtoria Arsimore është në proçesin e hartimit të një liste me datat, kur shkollat e mesme mund të presin vizitorë. Kjo listë, kur të plotësohet do të afishohet në schoolselect.philasd.org. Ju lutemi kontaktoni shkollat që keni interes për datat dhe orarin e vizitës tuaj, ose mundësive të tjera për të vizituar shkollën.

Në rast se nuk i plotësoj kërkesat strikte të një shkolle selektive, duhet që gjithsesi Unë të bëj aplikim?

Po, ne i inkurajojmë të gjithë nxënësit e interesuar të aplikojnë, por vetëm nëse të dhënat tuaja janë afër kërkesave të shkollës. Në rastet e tilla, drejtorët e shkollave selektive, mund të kërkojnë rekomandime prej personave të tjerë të rritur, të cilët kanë njohje me nxënësin. Gjithashtu, intervistat në këto raste mund të bëjnë diferencë të madhe në pranim.

Në rast se nuk jam pranuar në asnjë prej shkollave ku Unë kam bërë aplikim, si duhet të vazhdoj?

Mos harroni se mundësitë tuaja për pranim rriten nëse aplikoni në shkollat, të cilat kanë kërkesa të përafërta me rezultatet dhe interesat tuaja profesionale. Ju lutemi, kini parasysh, që të gjithë nxënësit e kanë të garantuar pranimin në shkollën e mesme të zonës së tyre.

A mundet që nxënësit me IEP, ose që mësojnë Anglisht, të aplikojnë në shkollat me kritere pranimi?

Drejtoria inkurajon të gjithë nxënësit të aplikojnë në shkollat që kanë interes, në rast ata kanë kualifikimin bazë për pranim në ato shkolla. Drejtoria e lehtëson dhe e mbron proçesin e aplikimit në shkollat selektive të nxënësve të klasave të 8-ta, të quajtur Proçesi i Pranimit LeGare (LeGare Advocacy Process). Nxënësit me programe mësimore individuale (IEPs), ose që janë nxënës ELL, mund të mësojnë më tepër prej këshilltarëve të tyre, nga drejtori dhe nga Zyra e Shërbimeve të Specializuara, në numrin 215-400-4170.

Ku tjetër mund të marr ndihmë për proçesin e aplikimit në shkollat e mesme?

Nxënësit dhe familjet e tyre, janë të inkurajuar të punojnë ngushtësisht me këshilltarin e shkollës së tyre. Udhëzime në lidhje me proçesin e Përzgjedhjes së Shkollës dhe proçedurat përkatëse, janë gjithashtu edhe në Qendrat për Prindin dhe Familjen. Prindërit mund të përdorin gjithashtu uebsajtet e Drejtorisë, ku mund të përftojnë profilet e shkollave, të bëjnë aplikimet online dhe të përdorin burime të tjera, që lidhen me këtë proçes.